

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar**

**P5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 24.09.2022

1. Sagan sh.a. e specializuar në prodhimin e veshëmbathjeve dhe ka aksione në dy kompani të tjera, Kepler sh.a dhe Eddington sh.a. Më poshtë janë pasqyrat e pozitës financiare të të tre kompanive më 31 dhjetor 2021.

#### Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021

	Sagan €'000	Kepler €'000	Eddington €'000
<b>Pasuritë</b>			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Pasuritë e paprekshme	70	-	-
Prona, fabrika dhe paisjet	1,500	2,600	805
Investimet	<u>10,430</u>	<u>600</u>	<u>400</u>
	12,000	3,200	1,205
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	500	500	300
Të arkëtueshmet tregtare	200	720	160
Banka	<u>50</u>	<u>220</u>	<u>180</u>
	<u>750</u>	<u>1,440</u>	<u>640</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>12,750</b>	<b>4,640</b>	<b>1,845</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<i>Ekuiteti</i>			
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	5,000	3,000	1,000
Fitimet e mbajtura	<u>6,200</u>	<u>700</u>	<u>500</u>
	11,200	3,700	1,500
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Kredi me interes 5%	200	40	100
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>			
Konsiderata kontigjente	200	-	-
Të pagueshmet tregtare	825	600	200
Tatimi	<u>325</u>	<u>300</u>	<u>45</u>
	<u>1,550</u>	<u>940</u>	<u>345</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>12,750</b>	<b>4,640</b>	<b>1,845</b>

#### Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- i) Sagan bleu 2,100,000 aksione të zakonshme në Kepler më 1 janar 2021, kur fitimet e mbajtura të Kepler ishin €420,000. Si konsideratë e blerjes, Sagan emetoi 1,000,000 aksione të ekuiteti. Çmimet e tregut të aksioneve të Sagan dhe Kepler në datën e blerjes ishin përkatësisht €4.5 dhe €3 secila. Përveç pagesës nepermjet aksioneve të saj, Sagan ra dakord të paguante edhe €230,000 në para më 1 janar 2022, gjë që ishte e kushtëzuar nga rritja e fitimit të Kepler prej 25% ose më shumë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021. Konsiderata kontigjente kishte një vlerë të drejtë prej €200,000 në datën e blerjes, megjithatë më 31 dhjetor 2021, Kepler raportoi një humbje. Sagan ka regjistruar si emetimin e aksioneve ashtu edhe konsideratën kontigjente.
- ii) Vlera e drejtë e pasurive neto të Kepler më 1 janar 2021 ishte e barabartë me vlerën kontabël të tyre, përveç një ndërtese, vlera e drejtë e së cilës e tejkalonte vlerën kontabël të saj për €200,000. Kepler nuk e ka rregulluar vlerën kontabël të kësaj ndërtese. Në atë

datë ndërtesa kishte një jetë të dobishme të mbetur prej 5 vitesh. Ndërtesat amortizohen në baza lineare

- iii) Sagan bleu 250,000 aksione të zakonshme të Eddington më 1 janar 2021 për një konsideratë parash prej €600,000 kur fitimet e mbajtura të Eddington ishin €380,000.
- iv) Investimet e tjera janë investime në ekuitet në entitetet tjera jashtë grupit Sagan dhe përfaqësojnë më pak se 10% të ekuitetit në ato entitete.
- v) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë). Për këtë qëllim, vlera e drejtë e çdo aksioni të Kepler më 1 janar 2021 është përfaqësuese e vlerës së drejtë të aksioneve të interesit jo-kontrollues.
- vi) Me 31 dhjetor 2021 është kryer një test i dëmtimit dhe rezultoi në një dëmtim të zërit të mirë në Kepler për €320,000 ndërsa investimi në Eddington nuk është dëmtuar.
- vii) Gjatë vitit financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021, Kepler i shiti mallra Saganit për €240,000. Këto mallra u shitën me një marzhë mbi kosto prej 50%. Nga këto mallra, 50% mbetën në stoqet e Sagan më 31 dhjetor 2021. Më 31 dhjetor 2021, Sagan i kishte borxh Keplerit €10,000 lidhur me blerjen e këtyre mallrave.
- viii) Asnjë dividend nuk është paguar apo propozuar gjatë vitit nga filiali ose shoqëria .
- ix) Gjatë dhjetorit 2021 Sagan u shiti mallra klientëve të jashtëm me një garanci që mbulon klientët për koston e riparimeve të çdo defekti që zbulohet brenda 1 viti pas blerjes. Përvoja e kaluar tregon që 50% e mallrave të shitura nuk do të kenë defekte, 30% do të kenë defekte të vogla dhe 20% do të kenë defekte të mëdha. Kostoja e riparimeve nëse të gjitha mallrat e shitura kanë defekte është €50,000 për defektet e vogla dhe €80,000 defektet e mëdha. Sagan nuk ka ndarë asnjë provizion për këtë garancion.
- x) Sagan gjithashtu ka shpenzuar €70,000 për trajnimin e punëtorve në përdorimin e pajisjeve të reja dhe e ka trajtuar këtë si pasuri pasi priten përfitime ekonomike në vitet e ardhshme për shkak të trajnimit të punëtorve.

**Kërkohet:**

**Përgatiteni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Sagan më 31 dhjetor 2021.  
(25 pikë)**

**Grupi Sagan**  
**Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

<b>Pasuritë</b>	<b>€'000</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Pasuritë e paprekshme 70 - L16 70	-
Prona, fabrika dhe paisjet 1,500 + 2,600 + 200 L12 - 40 L12	4,260
Zëri i mirë L14	3,460
Investimet në shoqëri L16	630
Investimet tjera 10,430 - 4,500 L13 - 200 L13 - 600 L15 + 600	<u>5,730</u>
	14,080
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet 500 + 500 - 40 L15	960
Të arkëtueshmet tregtare 200 + 720 - 10 L19	910
Banka 50 + 220	<u>270</u>
	<u>2,140</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>16,220</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
<i>Ekuiteti</i>	
Aksionet e zakonshme	5,000
Fitimet e mbajtura L17	6,245
IJK L19	<u>2,664</u>
	13,909
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Kredi me interes 5% 200 + 40	240
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Konsiderata kontigjente 200 - 200	-
Provizionet për garancion L16	31
Të pagueshmet tregtare 825 + 600 - 10 L19	1,415
Tatimi 325 + 300	<u>625</u>
	<u>2,311</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>16,220</b>
<b>Llogaritjet</b>	<b>€'000</b>

L11 Struktura e grupit

Sagan tek Kepler  $2,100/3,000 \times 100\% = 70\%$ ; IJK 30%  
Sagan tek Eddington  $250/1,000 \times 100\% = 25\%$

L12 Neto pasuritë e Kepler

	Në blerje 1 janar 2021	Në fund të vitit 31 dhjetor 2021
Aksionet e zakonshme	3,000	3,000
Fitimet e mbajtura	420	700
<i>Korigjimet e vleres së drejtë:</i>		
Ndërtesa	200	200
Zhvlerësimi shtesë 200/5 vite	<u>-</u>	<u>(40)</u>
	3,620	3,860

Ll3 Zëri i mirë

Konsiderata në aksione 1,000 x €4.5	4,500
Konsiderata kontigjente	200
IJK: (3,000 x 30%) x €3	<u>2,700</u>
	7,400
Minus neto pasuritë në blerje Ll2	<u>(3,620)</u>
Zëri i mirë në blerje	3,780
Minus humbja nga dëmtimi	<u>(320)</u>
<b>Shuma bartëse me 31 dhjetor 2021</b>	<b>3,460</b>

Ll4 Fitimi i perealizuar

Kepler tek Sagan	
Shitja	240
KMSH (KMSH + 50% x KMSH = 240,000)	<u>160</u>
Fitimi	80
Fitimi i perealizuar (80 x 50%)	<b>40</b>

Ll5 Investimi në shoqëri

Kosto e investimit	600
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes që i takon prindit (500 - 380) x 25%	30
Minus demtimi	<u>-</u>
	<b>630</b>

Ll6 Korigjimet

Prvizionet për garancion të mallrave (50 x 30%) + (80 x 20%) = 31		
Debi	Fitimet e mbajtura të prindit (40 x 70%)	31
Kredi	Provizionet për garancion	31
Kosto e trajnimit		
Debi	Fitimet e mbajtura të prindit	70
Kredi	Pasuritë e paprekshme	70

Ll7: Fitimet e mbajtura

	<b>Sagan</b>	<b>Kepler</b>	<b>Eddington</b>
Sipas pyetjes	6,200	700	500
Para blerjes		<u>(420)</u>	<u>(380)</u>
Pjesa e fitimeve pas blerjes		280	120
Fitimi i perealizuar Ll5		(40)	
Zhvlerësimi shtesë		(40)	
Dëmtimi i zërit të mirë Ll4		<u>(320)</u>	
		(120)	
Zvogëlimi në konsideratën kontigjente	200		
Provizionet për garancion	(31)		
Shpenzimet e trajnimit	(70)		
Fitimi i filialit që i takon prindit (120) x 70%	(84)		
Fitimi i shoqërisë që i takon prindit 120 x 25%	<u>30</u>		
	<b>6,245</b>		

LL8 IJK

VD në blerje (L13)	2,700
Pjesa e fitimeve që i takon IJK (120) x 30%	<u>(36)</u>
	<b>2,664</b>

LL9: Detyrimet ndërgurpore

Debi	Të pagueshmet tregtare	10	
Kredi	Të arkëtueshmet tregtare		10

2.

a) Me 1 janar 2020, Cassini sh.a u financua duke emetuar një obligacion dyvjeçar me zbritje të madhe me vlerë nominale €50,000 dhe interes prej 2% i pagueshëm në fund të çdo viti. Është emetuar me një zbritje prej 5% dhe është i ribleshëm me një premi prej €2,000 me 1 janar 2022. Nuk kishte kosto të emetimi. Obligacioni ka një normë efektive interesi prej 6.7% (e rrumbullakësuar).

**Kërkohet:**

**Tregoni duke treguar llogaritjet se si Cassini sh.a duhet të kontabilizoj obligacionin e mësipërm në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 në pajtim me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar. (5 pikë)**

b) Messier sh.a shiti dhe i dorëzoi pajisjet një klienti më 1 janar 2021 për një çmim total prej €2.1 milion të pagueshëm në 3 këste të barabarta në intervale 12 mujore prej €700,000, ku i pari ishte paguar në datën e shitjes (dorëzimit) dhe dy këstet e mbetura do të paguheshin më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2022. Dy këstet e paguara gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2021 janë pranuar në datat e tyre përkatëse 1 janar 2021 dhe 31 dhjetor 2021. Përveç kësaj, Messier sh.a do t'i servisojë dy here pajisjet pa kosto shtesë për klientin me datat 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2022. Shërbimet do të kryhet në një moment. Messier sh.a normalisht do të ngarkonte €50,000 për çdo servisim të paisjes. Norma e aplikueshme e interesit në financimin e operacioneve tregtare të Messier sh.a është 10%.

Viti	Faktori i skontimit 10%
1	0.909
2	0.826

**Kërkohet:**

**Tregoni duke treguar llogaritjet se si Messier sh.a duhet të kontabilizoj obligacionin e mësipërm në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 në pajtim me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar. (6 pikë)**

c) *Korniza konceptuale* përkufizon matjen si procesi i përcaktimit të shumave monetare me të cilat elementet e pasqyrave financiare duhet të njihen dhe të barten në pasqyrës së pozitës financiare dhe në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

**Kërkohet:**

**Tregoni dhe shpjegoni bazat e matjës që lejohet të përdorën në pasqyrat financiare. (4 pikë)**

**Total (15 pikë)**

2.

a) Obligacioni nuk ka kosto të emetimit dhe është emëtuar me një zbritje prej 5% duke rezultuar më arkëtime nga emetimi në shumë prej €47,500. Interesi është i pagueshëm në vlerë nomilale prej €1,000 çdo vit në fund të vitit. Në fund të vitit të 2-të shuma e ripagueshme për kryegjënë e obligacionit është €53,000 duke përfshirë preminë prej €2,000 dhe interesin €1,000.

Data e raportimit	Saldo fillestare	Norma efektive 6.7%	Paraja e paguar	Saldo në fund
	€	€	€	€
31 dhjetor 2020	47,500	3,182.5	(1,000)	49,682.5
31 dhjetor 2021	49,682.5	3,328.5	(1,000)	52,011*

\*Diferenca për shkak të rribullakësimit të normës efektive të interesit prej 6.689% në 6.7%

#### Cassini sh.a

**Ekstrakt i pasqyrës së fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.**

Kosto financiare	€
	3,328.5

**Ekstrakt i pasqyrës së pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

Detyrim financiar	€
	52,000

b) Të ardhurat nga shitja dhe servisimi i pajisjeve duhet të njihen në përputhje me SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*. Standardi kërkon që të ardhurat duhet të njihen vetëm pas përmbushjes së detyrimeve të performancës. Në këtë rast, ka dy detyrime të performancës, dorëzimi i pajisjes dhe servisimi i mëpasshëm. Të ardhurat që i atribuohen dorëzimit të pajisjeve duhet të njihen më 1 janar 2021, ndërsa ato për çdo shërbim në datën e shërbimit (2021 dhe 2022). Prandaj, shuma totale e arkëtueshme duhet të ndahet dhe t'i atribuohet çdo detyrimi të performancës. Më tej, shumat e arkëtueshme pas përmbushjes së detyrimeve të performancës duhet të skontohen. Mund të supozohet se shuma për secilin shërbim është nga kësti që duhet paguar në datën e shërbimit, me ç'rast nuk ka nevojë të skontohen të ardhurat për servisim.

#### Messier sh.a sh.a

**Ekstrakt i pasqyrës së fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.**

Të hyrat nga shërbimi 31 dhjetor 2021	€
	50,000
Të hyrat për dorëzim të pajisjes 1 janar 2021 (Llogaritja)	1,827,750
Të hyrat nga interesi (1,827,750 - 700,000) x 10%	<u>112,775</u>
<b>Total të hyrat për vitin 2021</b>	<b>1,990,525</b>

**Ekstrakt i pasqyrës së pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

Të arkëtueshmet me 31 dhjetor 2021 (650,000 x 0.909)	590,850
--	---------

#### Llogaritja

Viti	Shuma	FS @ 10%	Shuma e skontuar
Viti 0	€700,000	1	€700,000
Viti 1	€650,000	0.909	€590,850
Viti 2	€650,000	0.826	<u>€536,900</u>
<b>Total</b>			<b>1,827,750</b>



c) Një numër i caktuar i bazave të ndryshme të matjes përdoret në pasqyrat financiare. Ato përfshijnë:

- Koston historike
- Koston vijuese
- Vlerën e realizueshme (të shlyerjes/shitjes)
- Vlerën e tanishme të rrjedhave të ardhshme të parasë

#### **Kostoja historike**

Pasuritë regjistrohen sipas shumës së paguar të parasë apo ekuivalentëve të parasë ose vlerën e drejtë të dhënë në kohën e blerjes (përvetësimit) të tyre. Detyrimet regjistrohen në shumën e të ardhurave të marra në shkëmbim për obligimin, apo në disa raste (psh. tatimi në të ardhura) në shumën e parasë apo ekuivalentëve të parasë që pritet për t'u paguar për të përmbushur një obligim në rrjedhën normale të biznesit.

#### **Kostoja vijuese**

Pasuritë mbahen (në regjistra) në shumën e parasë apo ekuivalentëve të parasë që do të paguheshin nëse pasuritë e njëjta do të bliheshin tani. Detyrimet mbahen në shumën e padiskontuar të parasë apo ekuivalentëve të parasë që do të kërkohej për të shlyer obligimin tani.

#### **Vlera e realizueshme (e shlyerjes/shitjes)**

- Vlera e realizueshme . Shuma e parasë apo ekuivalentëve të parasë e cila tani do të mund të merrej përmes shitjes së një pasurie në mënyrë të rregullt.
- Vlera e shlyerjes/shitjes . Shuma e padiskontuar e parasë apo ekuivalentëve të parasë e cila pritet të paguhet për të përmbushur detyrimet në rrjedhën normale të biznesit.

#### **Vlera e tanishme**

Vlerësimi vijues i vlerës së tanishme të diskontuar të rrjedhave të ardhshme neto të parasë në rrjedhën normale të biznesit.

3. Copernicus sh.a është duke shikuar blerjen e njërës prej dy kompanive Huygens sh.a dhe Galilei sh.a të cilat operojnë në të njëjtën industri. Pasqyrat financiare të këtyre dy kompanive janë paraqitur me poshtë.

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

	<b>Huygens</b>	<b>Galilei</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të hyrat	25,000	40,000
Kosto e shitjes	<u>(20,000)</u>	<u>(32,000)</u>
Fitimi bruto	5,000	8,000
Shpenzimet operative	(1,000)	(2,000)
Kosto financiare	<u>(400)</u>	<u>(250)</u>
Fitim para tatimit	3,600	5,750
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(360)</u>	<u>(575)</u>
<b>Fitimi i vitit</b>	<b>3,240</b>	<b>5,175</b>
Shënim: Dividenda e paguar gjatë vitit	1,000	2,000

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

	<b>Huygens</b>	<b>Galilei</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	20,000	15,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	5,000	7,000
Të arkëtueshmet tregtare	4,000	7,900
Banka	<u>1,000</u>	<u>-</u>
	<u>10,000</u>	<u>14,900</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>30,000</b>	<b>29,900</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	5,000	10,000
Rezerva e rivlerësimit	2,000	1,000
Fitimet e mbajtura	<u>5,000</u>	<u>3,000</u>
	12,000	14,000
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Kredi me interes 5%	9,000	5,500
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Mbiterheqja bankare	-	3,000
Të pagueshmet tregtare	7,000	7,000
Tatimi aktual	<u>2,000</u>	<u>400</u>
	<u>9,000</u>	<u>10,400</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>30,000</b>	<b>29,900</b>

Drejtorët e Copernicus sh.do të dëshirojnë të kryejn një analizë financiare krahasuese të dy kompanive para blerjes, duke u bazuar në pasqyrat financiare dhe duke përdorur koeficientët e mëposhtëm:

- Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA)
- Qarkullimi i pasurisë neto
- Marzha e fitimit bruto
- Marzha e fitimit para interesit dhe tatimit
- Koeficienti i qarkullimit
- Koeficienti i shpejtë
- Periudha e qarkullimit të stoqeve
- Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme
- Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme
- Hyrja në borxh/leverazhi
- Mbulimi i interesit
- Mbulimi i dividendës

**Kërkohet:**

- (a) Llogaritni koeficientet e mësipërme për Huygens sh.a dhe Galilei sh.a bazuar në pasqyrat financiare të mësipërm. (12 pikë)
- (b) Përgatitni një raport drejtuar bordit të drejtorëve të Copernicus sh.a që vlerëson performancën financiare relative dhe pozitën financiare të Huygens dhe Galilei për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. (8 pikë)

(Total: 20 pikë)

a)

**KNKA = Fitimi para interesit dhe tatimit / (Ekuiteti i aksionarëve plus Detyrimet afatgjata) x 100**

Huygens  $(3,600 + 400) / (12,000 + 9,000) \times 100 = 19.0\%$

Galilei  $(5,750 + 250) / (14,000 + 5,500) \times 100 = 30.8\%$

**Qarkullimi i pasurisë neto = Shitjet / (Pasuritë totale - Detyrimet afatshkurtëra)**

Huygens  $25,000 / (30,000 - 9,000) = 1.19$  here

Galilei  $40,000 / (29,900 - 10,400) = 2.05$  here

**Marzha e fitimit bruto = Fitimi bruto / Shitjet x 100**

Huygens  $5,000 / 25,000 \times 100 = 20\%$

Galilei  $8,000 / 40,000 \times 100 = 20\%$

**Marzha e fitimit para interesit dhe tatimit = Fitimi para interesit dhe tatimit / Shitjet x 100**

Huygens  $(3,600 + 400) / 25,000 \times 100 = 16\%$

Galilei  $(5,750 + 250) / 40,000 \times 100 = 15\%$

**Koeficienti i qarkullimit = Pasuritë afatshkurtëra / Detyrimet afatshkurtëra**

Huygens  $10,000 / 9,000 = 1.11 : 1$

Galilei  $14,900 / 10,400 = 1.14 : 1$

**Koeficienti i shpejtë = (Pasuritë afatshkurtëra - Stoqet) / Detyrimet afatshkurtëra**

Huygens  $(10,000 - 5,000) / 9,000 = 0.55 : 1$

Galilei  $(14,900 - 7,000) / 10,400 = 0.76 : 1$

**Periudha e qarkullimit të stoqeve = Stoqet / Kosto e shitjes x 365 ditë**

Huygens  $5,000 / 20,000 \times 365 \text{ ditë} = 91 \text{ ditë}$

Galilei  $7,000 / 32,000 \times 365 \text{ ditë} = 80 \text{ ditë}$

**Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme = Llogaritë e arkëtueshme / Të hyrat x 365 ditë**

Huygens  $4,000 / 25,000 \times 365 \text{ ditë} = 58 \text{ ditë}$

Galilei  $7,900 / 40,000 \times 365 \text{ ditë} = 72 \text{ ditë}$

**Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme = Llogaritë e pagueshme / Kosto e shitjes x 365 ditë**

Huygens  $7,000 / 20,000 \times 365 \text{ ditë} = 128 \text{ ditë}$

Galilei  $7,000 / 32,000 \times 365 \text{ ditë} = 80 \text{ ditë}$

**Hyrja në borxh/leverazhi = Borxhi me interes / (Ekuiteti i aksionarëve borxhi me interes) x 100**

Huygens  $9,000 / (12,000 + 9,000) = 42.85\%$

Galilei  $5,500 / (14,000 + 5,500) = 28.20\%$

**Mbulimi i interesit = Fitimi para interesit dhe tatimit / Pagesat e interesit (kosto financiare)**

Huygens  $(3,600 + 400) / 400 = 10$  here

Galilei  $(5,750 + 250) / 250 = 24$  here

## **Mbulimi i dividendës = Fitimi për aksion / Dividenda për aksion (të zakonshëm)**

### Huygens

FPA = €3,240/5,000 aksione = €0.648 për aksion

DPA = €1,000/5,000 aksione = €0.20 për aksion

### Galilei

FPA = €5,175/10,000 aksione = €0.5175 për aksion

DPA = €2,000/10,000 aksione = €0.20 për aksion

## **Mbulimi i dividendës**

Huygens                      €0.648 / €0.20 = 3.24 here

Galilei                        €0.5175 / €0.20 = 2.59 here

**(b)**

## **RAPORT**

**Për : Drejtorët e Copernicus sh.a**

**Nga: Analisti financiar**

**Data : 24 shtator 2022**

**Tema: Analiza e koeficientëve financiar të Huygens sh.a and Galilei sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.**

## **Hyrje**

Ky raport analizon performancën dhe pozitën financiare të Huygens sh.a dhe Galilei sh.a duke përdorur analizën e koeficientëve. Fushat e analizës përfshijnë rentabilitetin dhe kthimin, likuiditetin, solventitetin, efikasitetin, leverazhin dhe performancën nga këndvështrimi i aksionarëve.

## **Rentabiliteti dhe kthimi**

Në përgjithësi, Galilei është shumë më fitimprurës se Huygens, i matur me kthimin në kapitalit e angazhuar (KNKA). KNKA e Galileit prej 30.8% është më e lartë se ajo e Huygens prej vetëm 19%. KNKA tradicionalisht shihet si një masë e efikasitetit të përgjithshëm të menaxhimit në përdorimin e kapitali afatgjatë (si borxhi ashtu edhe ekuiteti).

Burimi kryesor i përfitimit superior të Galileit është aftësia e tij për të gjeneruar të ardhura duke përdorur kapitalin e disponueshëm të matur nga qarkullimi i pasurive neto (kapitalit). Qarkullimi i pasurive neto të Galileit është 2.05 herë ndërsa ajo e Huygens vetëm 1.19 herë. Prandaj, qarkullimi i pasurive neto të Galileit është rreth dyfishi i asaj të Huygens. Marzhet e fitimit të dy kompanive (fitimi bruto dhe fitimi para interesit dhe tatimit) janë gjerësisht të ngjashëm edhe pse Huygens ka një avantazh të vogël në performancën e marzhit të fitimit bruto. Mund të ndodhë që Huygens vendosë çmime më të larta se Galilei ose ka kontroll më të mirë të kostos (si kostoja e shitjeve ashtu edhe kostot e tjera operative) sesa Galilei. Huygens ka fitim bruto dhe marzhe fitimi operativ prej 20% dhe 16% krahasuar me ato të Galileit me përkatësisht 20% dhe 15%. Si përfundim, Galilei është një kompani më e mirë për blerje sesa Huygens për sa i përket rentabiliteti dhe kthimit.

## **Aftësi afatshkurtër paguese dhe likuiditeti**

Të dyja kompanitë duket se kanë likuiditet relativisht të ulët të matur me koeficientin qarkullues. Të dyjat Huygens dhe Galilei kanë afërsisht të njëjtin raport aktual prej 1.11 dhe 1.14 respektivisht. Huygens është në një pozicion më të mirë me një bilanc të parave prej €1

milion në bankë ndërsa Galilei ka një mbitërheqje bankare në shumën €3 milionë. Në këtë drejtim, politika e e Galileit për pagesa të larta të dividendëve (që rezultojnë në një mbulim të ulët të dividendit dhe fitime të ulëta të pashpërndara) janë shumë të diskutueshme.

### **Efikasiteti**

Duke parë më detajisht Galiein qarkullon më shpëjtë stoqet. Huygens mbledh të arkëtueshmet dy javë më herët se Galiein (edhe pse Galiein shfrytëzon mbitërheqjen), dhe ndryshimi i dukshëm është se Huygens merr (ose paguan) një periudhë shumë më të gjatë kredie nga furnitorët e saj (128 ditë krahasuar me 78 ditë). Ky mund të jetë një reflektim i aftësisë së Huygens për të negociuar kushte më të mira kredie për shkak të mundësisë që ka një vlerësim më të lartë kreditor.

### **Aftësia afatgjatë paguese dhe solventiteti**

Nga koeficienti i leverazhit mund të shihet se Huygens ka një koeficient të hyrjes në borxh me të lartë se Galiein, 42.85% kundrejt 28.20%. Hyrja në borxh ose leverazhi është, një përpjekje për të përcaktuar shkallën e rrezikut që përfshihet në mbajtjen e aksioneve të ekuitetit në një kompani. Edhe mbulimi i interesit është më i ulët në Huygens. Mbulimi me interes të ulët të Huygens është i drejtpërdrejtë pasojë e leverazhit të lartë dhe i bën fitimet të cenueshme ndaj ndryshimeve relativisht të vogla në aktivitetin operativ. Për shembull, reduktime të vogla në shitje, marzhe fitimi ose të vogla rritja e shpenzimeve operative mund të rezultojë në humbje dhe do të thotë se kostot e interesit do të të mos mbulohen.

### **Interesat e aksionarëve**

Mbulimi i dividendës tregon përpjesëtimin e fitimit për vit që është në dispozicion për distribuim të aksionarët që janë paguar (ose propozuar) dhe se çfarë përpjesëtimi do të mbahet në biznes për të financuar zhvillimin në të ardhmen. Tregon aftësinë e një kompanie për të paguar dividendë nga fitimi që u atribuohet aksionerëve. Me fjalë të tjera, ai tregon numrin e herëve që një kompani mund të paguajë dividendë për aksionarët nga të fitimet neto. Galiein ka një koeficient më të ulët të mbulimit të dividendit që nënkupton që ka paguar një pjesë të madhe të fitimeve të saj si dividendë.

### **Konkluzion**

Të hyrat e Galileit nga shitjet janë mbi 60% më shumë se ato të Huygens, dhe financohet nga nivele të ulëta të borxhit. Kthimi i përgjithshëm i Galileit duket më tërheqës se ai i Huygens, ai do të përfaqësojë gjithashtu një investim më pak të rrezikshëm dhe likuiditet pak me të lartë. Galiein ka hapësirë më të madhe edhe për përmirësimin e menaxhimit e kapitalit punues. Në fund të fundit, vendimi i investimit duhet të përcaktohet nga sinergjitë e mundshme me aktivitetet ekzistuese të Copernicus, dhe gjithësesi nga çmimi i kërkuar për këtë investim pasi që, jo gjithmone një kompani e mirë paraqet një investim të mirë. Një kompani e mirë është një investim i mirë vetëm kur paghet çmimi i duhur për të.

4. Hubble sh.a ka përgatitur draft pasqyrat financiare për tu finalizuar nga ju.

**Hubble sh.a**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021**

	€'000
Të hyrat	50,000
Shpenzimet e lëndës së parë	(25,000)
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit	(7,000)
Kritja në stoqe	2,000
Shpenzimet e pagave	(5,000)
Kosto e shërndarjes	(1,000)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(4,000)
Shpenzimet e interesit	(500)
Dividenda e paguar	<u>(500)</u>
	<b>9,000</b>

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

	€'000
<b>Pasuritë</b>	
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Toka dhe ndërtesa	30,000
Fabrika	15,000
Paisjet	<u>5,000</u>
	50,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Parapagimet	500
Të arkëtueshmet tregtare	8,000
Stoqet	5,000
Paraja në bankë	<u>500</u>
	<u>14,000</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>64,000</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
<i>Ekuiteti</i>	
Kapitali aksionar	30,000
Rezerva e rivlerësimit	7,000
Fitimet e mbajtura	<u>15,000</u>
Total ekuiteti	52,000
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Kredi me 10%	5,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	<u>7,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>64,000</b>

**Informata shtesë të rëndësishme:**

- (i) Gjatë vitit janë rivlerësuar toka dhe ndërtesa për €7 milionë (elementi i tokës €2 milionë). Si rezultat zhvlerësimi i ndërtesave është rritur për €500,000 në vit. Hubble sh.a ka një politikë të transferimit vjetor të zhvlerësimit shtesë nga rezerva e rivlerësimit në fitimet e pashpërndara. Rivlerësimi tashmë është kontabilizuar në draft pasqyrën e pozitës financiare, por transferimi nga rezerva e rivlerësimit në fitimet e mbajtura ende nuk është bërë. (Injoro efektin tatimor të rivlerësimit).
- (ii) Zhvlerësimi shpërndahet si në vijim:
- |  |       |
|--|-------|
|  | €'000 |
| Ndërtesa (50% prodhim, 50% administratë) | 1,000 |
| Fabrika (100% prodhim)                   | 2,000 |
| Paisjet (30% prodhim, 70% administratë)  | 1,000 |
- (iii) Shpenzimet e pagave përbëjnë 50% prodhim, 30% administratë dhe 20% shpërndarje.
- (iv) Tatimi në fitim prej €2.0 milionë për fitimet e vitit 2021 ende nuk është regjistruar. Një nën-provizionim i detyrimeve tatimore lidhur me tatimin për fitimet e vitit 2020 prej €1,000,000 është identifikuar me 5 janar 2022 dhe nuk është reflektuar në draft pasqyrat financiare.

**Kërkohet:**

- (a) Përgatite pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021. (10 pikë)
- (b) Përgatite pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021. (6 pikë)
- (c) Përgatite pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021. (4 pikë)
- Total (20 pikë)



**Hubble sh.a**

**a) Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.**

	€'000
Të hyrat	50,000
Kosto e shitjes (L1)	<u>(35,300)</u>
Fitimi bruto	14,700
Shpenzimet administrative (L1)	(2,700)
Kosto e shërndarjes (L1)	<u>(2,000)</u>
Fitimi para interesit dhe tatimit	10,000
Shpenzimet e interesit	(500)
Fitimi para tatimit	9,500
Tatimi (L2) (2,000 +1,000)	<u>(3,000)</u>
<b>Fitimi pas tatimit</b>	<b>6,500</b>
<i>TTGJ</i>	
Rivlerësimi i pronës	<u>7,000</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>13,500</b>

**b) Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

€'000

**Pasuritë**

*Pasuritë jo-qarkulluese*

Prona, fabrika dhe paisjet 50,000

*Pasuritë qarkulluese*

Stoqet 5,000

Të arkëtueshmet tregtare dhe parapagimet (8,000 + 500) 8,500

Paraja në bankë 500

14,000

**Total pasuritë** **64,000**

**Ekuiteti dhe detyrimet**

*Ekuiteti*

Kapitali aksionar 30,000

Rezerva e rivlerësimit (7,000-500) 6,500

Fitimet e mbajtura (L2) 12,500

Total ekuiteti 49,000

*Detyrimet afatgjata*

Kredi me 10% 5,000

*Detyrimet afatshkurtëra*

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera 7,000

Tatimi (2,000 + 1,000) 3,000

10,000

**Total ekuiteti dhe detyrimet** **64,000**

c) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

	Kapitali aksionar €'000	Rezerva e rivlerësimit €'000	Fitimet e mbajtura €'000	Total €'000
Saldo në fillim të vitit	30,000	-	6,000	36,000
Dividenda e paguar			(500)	(500)
Fitimi i vitit			6,500	6,500
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:				
Rivlerësimi i tokës dhe ndërtesë		7,000	-	7,000
Transfer i zhvlerësimit shtesë		<u>(500)</u>	<u>500</u>	<u>0</u>
<b>Saldo në fund të vitit</b>	<b>30,000</b>	<b>6,500</b>	<b>12,500</b>	<b>49,000</b>

Llogaritjet

1 Alokimi i shpenzimeve

	Kosto e shitjes €'000	Adminstrata €'000	Shpërndarja €'000
Shpenzimet e lëndës së parë	25,000		
SHPP	7,000		
Rritja në stoqe	(2,000)		
Shpenzimet e pagave (50%,30%,20%)	2,500	1,500	1,000
Kosto e shërndarjes			1,000
<i>Shpenzimet e zhvlerësimit</i>			
Ndërtesa (50%,0%, 50%)	500	500	
Fabrika (100%,0%,0%)	2,000		
Paisjet (30%,70%,0%)	<u>300</u>	<u>700</u>	
	<b>35,300</b>	<b>2,700</b>	<b>2,000</b>

2 Fitimet e mbajtura

	€'000	€'000
Fitimet e mbajtura sipas pyetjes		15,000
Minus tatimi		
- I vitit aktual 2021	2,000	
- Nën-provizionimi i vitit 2020	<u>1,000</u>	(3,000)
Shto transferimin në zhvlerësimin shtesë të ndërtesës		<u>500</u>
		<b>12,500</b>

5.

a) Sipas SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*, një entitet duhet të vlerësojë në fund të çdo periudhe raportuese nëse ka indikacione për dëmtimin e ndonjë pasurie. Nëse ekzistojnë indikacione për dëmtime të mundshme, prej entitetit kërkohet të bëjë një vlerësim formal të shumës së rikthyeshme të pasurisë në fjalë. Disa pasuri duhet gjithnjë të testohen për testim në baza vjetore edhe kur nuk ka indikacione të dëmtimit.

**Kërkohet:**

- i) **Shojgo se si matet shuma e rikthyeshme e një pasurisë. (3 pikë)**
- ii) **Tregoni se cilat janë ato pasuri që u kërkohet gjithnjë të testohen për testim në baza vjetore edhe kur nuk ka indikacione të dëmtimit sipas SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*. (3 pikë)**

b) Ptolemy sh.a është një kompani që raporton sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe përgatit pasqyrat e saj financiare deri më 31 dhjetor të çdo viti.

Më 1 janar 2021, Ptolemy sh.a bleu një fabrikë që kushtonte €1,000,000 dhe ka një jetë të dobishme prej 5 vjetësh pa vlerë të mbetur dhe zhvlerësohet me metoden drejtvizore për qëllim të raportimit financiar. Norma e zhvlerësimit për qëllime tatimore është 25%. Të ardhurat e krijuara nga përdorimi i fabrikës janë të tatueshme dhe çdo fitim nga shitja/largimi i fabrikës do të jetë i tatueshëm si dhe çdo humbje nga shitja/largimi i fabrikës do të jetë e zbritshme për qëllime tatimore. Ptolemy sh.a vlerëson provizionin aktual tatimor për vitin deri më 31 dhjetor 2021 në €10,000. Norma tatimore e Ptolemy sh.a është 10%.

**Kërkohet:**

- i) **Shpjegoni termin diferencë të përkohshme dhe tregoni një rrethanë në të cilën mund të lindë diferenca e përkohshme. (2 pikë)**
- ii) **Në përputhje me SNK 12 *Tatimet mbi të Ardhurat*, shpjegoni shumat që duhet të raportohen në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. (5 pikë)**

c) Herschel sh.a një kompani e Kosovës fundi i vitit i të cilës është data 31 dhjetor 2021, blen disa mallra nga deGrasse Tyson sh.a nga SHBA-ja në datën 30 shtator 2021. Vlera e faturës është \$60,000 dhe do të duhet të shlyhet me dy shuma të barabarta në datat 30 nëntor 2021 dhe 28 shkurt 2022. Kursi i këmbimit valutor ka lëvizur si vijon.

	1€ =
30 shtator 2021	\$1.50
30 nëntor 2021	\$1.60
31 dhjetor 2021	\$1.80
28 shkurt 2022	\$1.70

**Kërkohet:**

- i) Shpjego dallimin ndërmjet zërave monetar dhe zërave jo-monetar dhe se si keta zëra përkthehen më pas në pajtim me SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor.* (3 pikë)**
  - ii) Tregoni hyrjet në kontabilitet në librat e Herschel sh.a në pajtim me SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor.* (4 pikë)**
- (total 20 pikë)**

5.

a)

- i) Shuma e rikthyeshme e një pasurie duhet të matet si vlera më e lartë e:
- vlerës së drejtë të pasurisë minus shpenzimet për të shitur; dhe
  - vlera e saj në përdorim.
- ii) Edhe kur nuk ka indikacione të dëmtimit, pasuritë në vijim duhet gjithnjë të testohen në baza vjetore.
- Një pasuri e paprekshme me jetë të pakufishme të përdorimit
  - Zëri i mirë i përfituar (blerë) në një kombinim biznesor

b)

i) Diferencat e përkohshme

Diferencat e përkohshme janë diferencat midis vlerave bartëse të një pasurie ose detyrimi në pasqyrën e pozitës financiare dhe bazës së vet tatimore.

Diferencat e përkohshme mund të krijohen në rrethanat e mëposhtme.:

- Zhvlerësimi kontabël nuk është i barabartë me zhvlerësimin e lejuar për qëllime tatimore.
- Një zë i të ardhurave ose shpenzimeve përfshihet në fitimin kontabël në një periudhë, por përfshihet në fitimin e tatueshëm në një periudhë tjetër. Për shembull, kostot e kapitalizuara të zhvillimit amortizohen gjatë disa viteve në pasqyrat financiare, por për qëllime tatimore njihen si shpenzim kur kostot paguhen (në bazë të parave të gatshme).
- Një pasurim me të drejtë përdorimi dhe detyrimi i qirasë mund të njihet sipas SNRF 16, ndërsa për qëllime tatimore pagesat e qirasë që janë një zbritje e lejuar në periudhën kur janë paguar sipas legjislacionit tatimor të juridiksionit përkatës (që do të thotë se pasuria dhe detyrimi nuk do të njihen sipas rregullave tatimore )

ii) **Pasqyra e pozitës financiare**

Ptolemy sh.a duhet të njoh një detyrim të tatimit të shtyrë prej €5,000 dhe një detyrim të tatimit aktual prej €10,000.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes**

Njih shpenzim të tatimit në fitim prej €15,000 (€10,000 + €5,000)

**L11 Vlera bartëse e fabrikës**

	€
Kosto me 31 dhjetor 2021	1,000,000
Zhvlerësimi (1,000,000/5 vite)	<u>(200,000)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2021	800,000

**L12 Baza tatimore e fabrikës**

	€
Kosto me 31 dhjetor 2021	1,000,000
Zhvlerësimi (1,000,000 × 25%)	<u>(250,000)</u>
Baza tatimore me 31 dhjetor 2021	750,000

LL2 Diferenca e përkohshme	€
Shuma bartëse	800,000
Baza tatimore	<u>(750,000)</u>
Diferenca e përkohshme e tatueshme	50,000

Tatimi i shtyrë (10% x €50,000) = €5,000

#### Hyrjet në ditar

Debi	Shpenzimet e tatimit në fitim	5,000	
Kredi	Detyrim i tatimit të shtyrë		5,000
Debi	Shpenzimet e tatimit në fitim	10,000	
Kredi	Detyrim i tatimit aktual		10,000

c)

i) Zërat monetar përfshijnë të drejtën për të pranuar ose obligimin për të dërguar një shumë fikse ose të paracaktueshme të një valute. Kjo do të përfshinte të arkëtueshmet, të pagueshmet, kreditë etj. Zërat jo-monetar do të ishin zërat e tillë si pasuritë jo-qarkulluese dhe stoqet.

Rregullat në vijim aplikohen për secilin fundvit pasues:

- (a) Raporto zërat monetar duke përdorur kursin e këmbimit në fund.
- (b) Raporto zërat jo-monetar (p.sh pasuritë jo-qarkulluese, stoqet) të cilat barten sipas kostos historike në një valutë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e trasanskionit (kursin historik)
- (c) Raporto zërat jo-monetar të cilët barten sipas vlerës së drejtë në një valutë të huaj duke përdorur kurset e këmbimit që kanë ekzistuar kur vlerat janë matur..

ii) Blerjet do të regjistrohen në librat e kompanisë Herschel sh.a duke përdorur kursin e këmbimit të datës 30 shtator 2021.

Debi	Blerjet	€40,000	
Kredi	Të pagueshmet tregtare		€40,000

ku shuma në € është kostoja e mallrave të blerë për €40,000 (\$60,000 /€1.50)

Me 30 nëntor, Herschel sh.a duhet të paguaj \$30,000. Kjo do të kushtoj \$30,000/1.6 = €18,750 dhe Herschel sh.a ka bërë një përfitim nga këmbimi prej €20,000 - €18,750 = €1,250.

Debi	Të pagueshmet tregtare	€20,000	
Kredi	Fitimi nga këmbimi: Fitim ose humbje		€1,250
Kredi	Paraja		€18,750

Me 31 dhjetor 2021, fundi i vitit, detyrimi i mbetur \$30,000 do të rillogaritet duke përdorur kursin e këmbimit të aplikueshëm në atë datë: \$30,000 / 1.8 = €16,667. Edhe një përfitim tjetër prej €3,333 është bërë dhe do të regjistrohet si në vijim.

Debi	Të pagueshmet tregtare	€3,333	
------	------------------------	--------	--

Kredi	Fitimi nga këmbimi: Fitim ose humbje	€3,333
-------	--------------------------------------	--------

Total përfitimi nga këmbimi prej €4,583 (€1,250 + €3,333) do të përfshihet në fitimin operativ për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.

Me 28 shkurt 2022, Herschel sh.a duhet të paguaj pagesën e dytë prej \$30,000. Kjo do tu kushtoj atyre €17,647 (\$30,000 /1.7).

Debi	Të pagueshmet tregtare	€16,667	
Debi	Humbja nga këmbimi: Fitim ose humbje	€980	
Kredi	Paraja		€17,647